

INTERVISTË ME ABDULLAH ZENELIN

Prishtinë | Data: 15 maj, 2018

Kohëzgjatja: 92 minuta

Të pranishëm:

- Abdullah Zeneli (I intervistuari)
- Aurela Kadriu (Intervistuesja)
- Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: A mundeni me prezentu veten edhe me na tregu diçka prej kujtimeve t'juja t'fëmijërisë? Domethanë me na tregu familjen në të cilën jeni rritë, vendin ku jeni rritë, edhe kontekstin pak. Çka mbani n'mend prej fëmijërisë?

Abdullah Zeneli: Po osht' interesant, unë kam lindur në fshat. Kam lindur para 66 vjete. Dhe osht' interesant ndoshta gjendja psiqike e nanës sime në shtatëzaninë time. Ka qenë ajo që ka përcaktu edhe fatin tim n'jetë, m'ka përcjellë ajo. Shumë interesant osht' sepse babi im ka qenë ushtar n'atë kohë. Ka ardhë n'pushim, ka shku. Mandej gjithë shtatëzaninë nana e ka pasë pa bashkëshortin, pa burrin. Edhe natyrisht një lidhje emocionale ka pasë me frytin e vet. Edhe mas shtatë-tetë muje që kom lindë unë ka ardh babai, domethanë osht' një periudhë shumë interesante. Edhe si duket ajo m'ka përcjellë n'jetë, gjithmonë diçka n'pritje, gjithmonë diçka, si të them, të ndërrosh ose hajt se bëhet më mirë.

Edhe si katër vjeç kem ardhë, jem shpërngulë nga fashti Sibofc i Llapit në Prishtinë. Domethanë nga viti 1956 unë jom qytetar i Prishtinës. E mbaj n'mend Prishtinën shumë interesante n'atë kohë. Nji qytet, çuditërisht frymë pak orientale. Flitej, aty-këtu flitej edhe turqisht edhe serbisht, shqipja ishte pak gjuhë e fshatarëve. Por unë kom pasë fatin e mirë se kam jetu në nji lagje tepër intelektuale që kishin ardhë nga Gjakova. Dhe faktikisht përplasja e kulturës nga fshati me kulturën si sillen gjakovarët për mu ka qenë tepër udhërrëfyese. Kam pa çka osht' zhvillimi, çka osht' niveli intelektual, gjuha e përsosur, jeta familjare... Pasuria e madhe, në kuptimin e plotënisë së ndërtimit të kulturës t'kuzhinës, kulturës t'sjelljes.

Dhe paramendoni nji fëmijë i fshatit që vjen në një rreth të tillë edhe menjherë krijon një botëkuptim krejt tjetër. Fati im që ka qenë afër edhe nji bibliotekë. Babi im e lexonte librin. M'çonte ta blej gazetën, gazetën shqip edhe serbo-kroatisht, mos t'harrojmë ka qenë koha e aksionit të armëve. Babi përdorte nji strategji shumë interesante krahas "Rilindjes" t'përditshme, se "Rilindja" e përditshme nga vitin 1958 ka filluar.

Edhe unë pa shkuar n'shkollë kam ditë shkrim dhe lexim. Edhe shqipen, por edhe cirilicën, serbo-kroatishtën me gazetën e përditshme atëhere "Borba". Edhe këtu ka filluar edhe interesimi im të

i qasem Biblotekës t'qyteti që ka qenë atëhere "Miladin Popoviq", sot osht' "Hivzi Sylejmani". Edhe lexoja libra, e plotësoja atë që mungonte. Edhe si duket libri ka qenë udhërrëfyes për jetën time, ma ka plotësuar shumë hapësirën, atë vakumin që njeriu s'di çka t'bëjë me kohën. Sidomos kur je një fëmijë i qytetit, sillësh rrugëve, fillon të ndërrojë qyteti, lagjet t'shumta rrënoheshin, ndërtoheshin t'reja. Bie fjala ku osht' përmendorja sot e Vllaznim Bashkimit, une e mbaj n'mend t'gjithë hapësinën aty me lokale. Mbaj n'mend edhe librarinë që ka qenë aty, në atë zonë. Dhe rrënohet qyteti i vjetër, rrënoheshin zanate të ndryshme...

Dhe unë çudi si fëmijë më dhimbsenin disa shitore që shkoja me babain, për shembull për t'marrë kostume, ose për t'ble këpucë, ose diçka tjetër, dhe ato t'nesërmen rrënoheshin. Edhe ato ngadalë-ngadalë i fusja n'kujtesë. Kujtesa... Osht' fati im që kom pasë edhe gjyshin nga nana edhe gjyshin nga baba që atë përvojën e tyre ma bartnin me rrëfime, përalla, me përjetime t'ndryshme.

Mos t'harrojmë, ose dua ta theksoj që gjyshi im nga baba ka qenë në kohën kur osht' mbajtë Kongresi i Manastirit, ai ka qenë ushtar në Manastir. Tash paramendoni përjetimet, ose rrëfimet e gjyshit tim, i cili ka qenë në vitin 1908-1912 në Manastir. Ne kohën e vlimeve t'mëdha kulturuore, politike të flakës t'ballaknit, t'Luftës t'Parë Ballkanike. Sespe ka qenë ushtar i peranodorisë Osmane. Edhe rrëfimet e tij kanë qenë për mua shumë domethënëse në orientimin tim nga kultura, nga tradita, nga letërsia, nga leximi, nga plotësimi apo pasurimi i botës shpirtërore.

Edhe në anën tjetër gjyshi nga nana, i cili ka kryer shkollën ma t'lartë atë kohë në Shkup, Medrezen. Ai nuk tregonte qe osht' i arsimuar sepse ka qenë koha shumë e vështirë, aksion t'armëve, periudha e Rankoviqit e t'gjitha. Por lexonte shumë, dhe unë habitesha se si ai njeri ishte n'gjendje 24 orë vetëm me libër përpara. Ndoshta edhe kanë qenë libra fetar bie fjala, sepse ajo Medrezeja, janë libra religjioni domethanë. Mirëpo për mua si fëmijë ka qenë shume magjike, ç'është ajo magji që e tërheqë atë që vazhdimisht t'jetë me librin.

Dhe vazhdimisht kisha përshytpjen që pa afruar gishtin faqja e librit të tij rotullohej. Për mua ishte shumë magjike kjo, dhe si duket ndoshta ishte udhërrëfyes që unë të orientohem në leximin e librit. Dhe natyrisht me librin kam arritë të gjitha përvojat e t'ardhmes, të ndërtimit apo të krijimit t'vizionit t'i marr nga libri. Dhe fati im që kom pasë arsimtarë shumë t'mirë, shumë t'mirë, qoftë në "Meto Bajrakari" në shkollën katër klasë ka qenë atë kohë shqip. Pastaj kaluam në ish shkollën "Vuk Kragjiq", që tash quhet "Elena Gjika". Domethanë kryerjen e fillores.

Pastaj aty ia kam bërë një tradhëti babit tim. Kishte dëshirë që t'a kryej një shkollë, të arrij më shpejtë në shkollë t'mesme, te t'ardhunat, te punësimi, te një shkollë që ka qenë... Se babai im ka qenë minator i thëngjillit. Dhe kishte dëshirë që atij, kishte disa lidhje, që ma shpejtë t'vi te puna. Natyrisht tradhëtinë e vetme që i'a kam bërë babait tim ka qenë mos sukcesi im në provimin pranues. I kom tërheqë dokumentet shpejtë e shpejtë, kam vrapuar në shkollën normae, dhe jam regjistruar në shkollën Normale.

Në shkollën Normale kam qenë një ndër nxënësit më të mirë të ish shkollës Normale. Normalen pesë vjeçare e kam kryer për katër vjet. Kam pasë n'brez timin Behgjet Pacollin, Jakup Krasniqin, e shumë

emra që kanë dalë nga ish normalja. Domethanë në Normale ka filluar ai gufimi im, sepse të gjithë kohën e lirë e kalojsha në bibliotekën e shkollës Normale.

Biblioteka e shkollës Normale ka qenë një ndër bibliotekat ma t'pasuna. Dhe qasja ime në leximin e librit ka qenë e jashtëzakonshme, normë vjetore kom pasë njëqind tituj të i lexoj. Domethanë llogaritet përafërsisht tre libra e gjysë... Tri ditë e gjysë një libër. Që i binte rreth njëqind tituj, ku përfshihen libra edhe pesëqind faqe, edhe gjashtëqind faqe, po edhe libra për fëmijë, pesëdhjetë faqe, tetëdhjetë faqe. Dhe nga ajo kohë kryeveprat botërore i kam lexuar, "Lufta dhe Paqja", "Ana Karenina", "Tragjedia Amerikane", e shumë, shumë libra të tjerë, që për mu ka qenë udhërrëfyes shumë i madh.

Ma vonë natyrisht m'u krijua mundësia që të studioj matematikën. I kam dashtë shumë shkencat ekzakte. Edhe për fat timin, për t'ma shmangur t'gjithë jetën time, shpallet një konkurs në "Rilindja". Shfrytëzova rastin, u pranova n'punë, te veprimtaria botuese. Sepse "Rilindja" ka qenë një ndërmarrje heterogjene. Ka pasë shtypshkronjën, gazetën, revistat e tjerë, e tjerë. Edhe në veprimtarinë botuese domethanë, edhe unë kom nxënë punë në vitin 1973. Kam ndërpre menjhëre studimet, sepse kisha nevojë familja që t'kontribuoj. Sepse jemi rritë katër vllazën, dhe katër motra. Kështu që kishte nevojë krahas t'ardhunave tepër modeste të babit tim si minator që ta ndihmoja familjen.

Mandej ngadalë-ngadalë u orientova në letërsi. Letërsi s'kishte problem sepse e njihja letërsinë, e kisha pasion leximin. Në "Rilindje" ngadalë- ngadalë ecëm përpara sepse ishin disa mundësi, ta vizitoje çdo trevë ku kishte shqiptarë, t'i furnizoje bibliotekat e shkollave, bibliotekat e qyteteve. Dhe nuk ka vend në hapësirën e ish-Jugosllavisë ku ka qenë e banuar me shqiptarë, që s'ka shkelë këmba ime, në përhapjen e librit në atë kohë. Domethanë që nga Ulqini, e deri te Struga ose Ohri në Maqedoni.

Domethanë kjo m'ka dhanë një përvojë tepër t'madhe t'i njoh njerëzit, t'i njoh kulturat, t'i njoh diverzitetet dhe të njoh shpirtin e popullit. Kërkesat që kanë, qoftë nxënësit, qoftë punuesit e ndryshëm, qoftë i gjithë spektri i hapësirave urbane, dhe ndërurabne. Kështu që ka qenë kjo përvojë jashtëzakonisht e madhe. Shto këtu edhe pjesëmarrjen nëpër panairë ku merrte pjesë "Rilindja" në atë botë... Si panairi i Brukselit, panairi i Frankfurtit, panairi i Bogradit, i Zgredit, i Lublanës.

Domethanë ka qenë një mundësi e madhe që të njifemi edhe një formë tjetër të shoh se si bota ecën me librin, se si krijon forma t'ndryshme që libri të jetë sa ma shumë afër, sa ma shpejtë. Dhe natyrisht laroshia e botimeve, përkthimet e ndryshme letrare. Unë kam pasë fatin e mirë që t'shkoj edhe në Shqipëri në vitin 1979-1980, në cilësinë e dërgimit t'librave, edhe t'marrjes t'librave, eksport-importi. E kom parë Shqipërinë e atyre viteve. Edhe natyrisht edhe kjo osht' një përvojë tepër e madhe për shkak se këtë zgjimin e ndërgegjijës kombëtare sigurisht që ka ndikuar shumë në eksport-importin e librit nga Shqipëria, i viteve '70. Ka filluar diku në '68, demonstratat e viti '68, unë atëhere kom qenë në shkollën Normale dhe mbaj n'mend shumë mirë se si kanë ndodhë ato veprime.

Pastaj edhe ma vonë '81-shi që u ndërpre në t'gjitha rrugët neve me Shqipërinë. Dhe e vetmja mundësi për t'u parë me botuesit dhe me librin e botuar në Shqipëri, ishte panairi i Frankfurtit. Domethanë ne e shfrytëzonim rastin që në Frankfurt të takoheshim me kolgët tanë atje dhe t'shiknim botimet e reja, letërsinë e përkthyer sidomos. Por edhe letërsinë origjinale që ne si letërsi kombëtare patjetër që

duhet kultivuar dhe duhet mbështetur, duhet përkrahur domethanë, ka ndikuar shumë n'afirmimin e saj. Edhe veprat që dilnin menjihere në Tiranë, i kishim edhe në Kosovë. Veprat madhore të Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit e kështu me rradhë, mos t'përmendi emra tjerë.

Dhe kjo ka lënë një pasuri t'madhe shpirtërore dhe gjithnjë këtë nektar jam përpjekur që ta zbërthej ose ta përtoj tek, punën që kom pasë si mision në përhapjen e librit në "Rilindje". Natyrisht erdhën vitet shumë t'vështira, sidomos viti '98-'90 kur filloi apart-heidi të ndodhë në Kosovë. Natyrisht me mbylljen e Televizionit edhe të *Rilindjes* duheshin iniciativa private, atëhere që krijonte mundësi ligji. Dhe e pata themeluar shtëpinë e parë botuese shqiptare, shtëpinë botuese "Buzuku".

Aurela Kadriu: A qëndrojmë edhe pak, ma detajshat po kom qef me folë me juve për familjen e juv? Qysh ka qenë jeta në familjen e juv?

Abdullah Zeneli: Po natyrisht përderi sa e kam kaluar një pjesë t'jetës në fshat, kemi t'bajmë me familje partiarkale ku, shumë antarëshe, ku janë disa breza brenda familjes. Domethanë gjyshërit, baba, axhallarët, dajët përshembull. Edhe familje e madhe me fëmijë, se thashë katër vllazën, katër motra. Dhe natyrisht osht' një plotëni gjithmonë, që je gjithmonë në lëvizje, gjithmonë një lloj zhurme në kuptimin pozitiv t'fjalës. Dhe kjo, unë e shoh shumë t'mirë këtë sepse sot njeriu, me këtë çka sheh, çka ndodhë në të gjithë botën, ka probleme me vetminë. Në ato familje partiarkale nëse ka pasë diçka t'mirë, ka qenë pikërisht kjo, se si nuk ndjehej i vetumar. Ke pasë me çfarë t'a plotësosh domethanë jetën edhe krijohen edhe divergjenca, krijohen edhe mospajtime, krijohen përplasje.

Se mos t'harrojmë gjithmonë osht' lufta me brezin dhe ke, rregullat jonë strikte domethanë, rregullat mos t'them diktatura familjare por brenda asaj natyrisht ecje, me zhvillim... Po them për fat t'mirë në familjen time osht' lexuar libri, ka qenë dritare e hapur zhvillimi.

Donjetë Berisha: Sa fëmijë keni qenë?

Abdullah Zeneli: Urdhnoni?

Donjetë Berisha: Sa fëmijë keni qenë?

Abdullah Zeneli: Katër vllazën, katër motra, jemi gjallë, dy... Se nëna ime ka lindë dhjetë fëmijë, dy pas meje kanë vdekë sepse rrethanat kanë qenë t'tilla dhe si duket nashta edhe ky ka qenë shkakun që diçka nuk po shkon n'fshat. Dhe babai morri familjen dhe u shpërngulëm në Prishtinë.

Ne, katër motra, katër vllazër jemi gjallë. Punojmë me çfarë na ofrohet mundësia. Unë pothuaj se i vetmi merrem me veprimtarinë botuese. Por është edhe një gja e mirë, që babai im, ndjesë pastë, ishte vizionar i madh me ato mundësi që kishte, me ato telashe që kishte, se si minator që ishte ai kishte probleme me shëndetin. Kishte mushknitë thëngjill, ka vuajtur shumë në pjesën e fundit të jetës, nja 17-18 vjet ka vuajtur shumë. Po jeta osht' e tillë.

Mirëpo me atë gjendje ai ka arritur që tri motra t'i diplomojë n'fakultet, dhe po ashtu edhe nga vllazërit, tre të diplomojmë, më atë rrogë modeste. Domethanë ka qenë vizionar i madh, me ato

probleme ka arritur që të ndihmojë zhvillimin. Edhe një gjë të tillë natyrisht nuk e kam imponuar as te fëmijët e mi, unë kam gjashtë fëmijë, katër djem e dy vajza.

Jom martuar në vitin më të vështirë që ka ndodhë në Kosovë, në ngjarjet e 1981-shit. Edhe nga atë botë domethanë erdhën n'jetë katër djem e dy vajza. Mburrem me atë se fëmija pa imponim kanë gjetë rrugën e tyre të ecjes përpara. Merren me gjëra krejtësisht të librit, kulturës. Por e mira osht' qe dy vajzat që i kam, janë shumë të pavarura, njëra ka kryer masterin para dy vjete në Nju Jork, tani është për doktoratë. Atje ka arritur me punë, me dije. Me njohjen perfekte të anglishtes.

Dhe me kontributin që ka dhënë në ndërrmarjen që ka bërë vetë me një shoqatë, ku ka ndihmuar shumë komunitetin në Fushë Kosovë. Komunitetet ju e dini si janë në Fushë Kosovë. Madje është nderuar dhe më një çmim organizata e saj, OJQ-ja, në Bashkimin European. Madje komisioneri european Shtefan Fyli ia ka dorëzuar personalisht në një aktivitet krahas shoqatave simotra të Malit të Zi, të Serbisë, Maqedonisë, të Shqipërisë, Kosovës.

Edhe detyra e një prindi është t'ndihmojë për aq sa mundet, por megjithatë po nisem nga fëmijët e mij, është një brez i cili ka vizionin e vet, i ka mundësitë e veta të zhvillimit. Kjo është gjë e mirë. Është gjë e mirë sepse nga një, nga një jetë apo nga një patriarkalitet si t'them, ose shoqëri konvencionale osht' arritë që për një kohë shumë t'shpejtë të ecim trendeve domethanë. Edhe këtë e ka krijuar mundësia domethanë, pas të '99-ës me ndihmën e faktorin ndërkombëtar, me mundësitë që janë hapur, me zhvillimet.

Edhe çka ndodhë, me kulmimin me pavarësinë natyrisht, kurrë, jam idhëtar i atyre, i atyre përpjekjeve që njeri kurrë nuk duhet të presë nga shteti, duhet vet të jetë, iniciativa duhet të fillojë nga vetëvetja. Edhe sukcesi, qoftë në fushën e botimeve, qoftë në fushën familjare, qoftë në fushën e angazhimit të fëmijëve, nuk osht' nvarë nga shteti por osht' nvarë nga iniciativa. Dhe nëse ti ke një iniciativë, kë një vizion, dhe mbështetë atë vision, je n'gjendje të sakrifikosh për atë vizion, sigurisht që edhe sukcesi nuk do të mungoj.

Dhe këtu e shoh une t'mirën, mbase kjo osht' edhe një përvojë, nga përvoja e familjës time, si ju thashë, nga gjyshërit e jeta e vështirë e babait tim... E deri te koha kur ke përjetuar apartedin, kur largoheshm nga puna dhe ishte e detyrueshme të merresh me diçka...

Donjetë Berisha: A mundeni me na tregu ma shumë për qetë periudhën e, domethanë kur ju kanë largu prej punës edhe...

Aurela Kadriu: Kisha nejtë fillimisht, m'thatë, na tregutë për babën ka qenë minator, nana...

Abdullah Zeneli: Nana, nana, osht' e çuditshme... Të gjitha nanat jonë t'mira, natyrisht, edhe, edhe kemi respektin të jashtëzakonshëm. Nëna ime përderisa ka pasur dhjetë lindje ka dashur një burrë, osht' sakrifikuar për atë burrë, ka rritur tetë fëmijë. Ka kontribuar që ata fëmijë të jenë të sukseshëm, edhe ka qenë analfabete. Kjo osht' çudia e saj. Ka qenë një nanë vizionare, një nanë që ka mbështetë fëmijët e vet. Kurrë s'kam dëgjuar një fjalë t'rëndë nga nëna, ndoj presion nga nana për shembull.

Edhe kjo osht' diçka shumë pozitive sepse fundi i fundit të gjitha nënat e tilla kanë qenë n'atë kohë. Kanë përjetuar shumë. Nëna ime babain e kishe shumë t'ngritun, në kuptimin e ndërgjegjes e t'gjitha. Mirëpo kishte edhe tjetër që ka mbetë herët jetime. Dhe gjithmonë e plotësonte atë mungesën e saj, e plotësonte me sukseset e fëmijëve, me angazhimin që fëmija të jenë t'suksesshëm.

Ne kemi detyrim shumë ndaj nanave. Ndoshta edhe kjo ka ndikuar që unë ta shkruaj një dramë për Nënë Terezë, por n'fakt e kam pasë model nanën time. Titulli i dramës është "Nana lutet për ne". T'gjitha nanat luten për fëmijët e vet. Edhe une e kom marrë si sinonim t'jetës, dhe punës të Nanës Terezë një dramë e cila... Duhet ta them m'ka mbeshtetë shumë Safete Rugova. Sepse me kalimin në amshim të Nanës Terezë në vitin 1997, në 1998, një vjetorin jam përpjekë që t'bëjmë diçka ma shumë për Nënë Terezë. Edhe lindi nevoja që t'shkruhet një dramë për Nënë Terezë.

Kushtet kanë qenë shumë t'vështira, do të ndalesha pak edhe në periudhën '90-'99. Periudhë shumë e vështirë, shumë e vështirë. Ne kemi pasë largime masive nga puna, njerëzit iknin, shkonin jashtë. Zbrazej Kosova, domethanë një diçka krejt, krejt rrethana të reja, dhe këto rrethana duhet të gjindet njeriu. Ose bie fjala fillimi i bombardimeve, largimi me dhunë nga shtëpitë, marshi deri në Bllacë. Kalimi një javë në Bllacë. Nuk dinim çfarë do të ndodhë, po me gjithatë ishte një knaqësi se shpëtuam nga terrori. Dhe në Bllacë një jav ditë nuk dinim as çfarë do të ndodhë fati ynë.

Aurela Kadriu: Kalojmë edhe aty zotni Zeneli. Por m'u duk shumë interesant, po kom qef me qëndru ende te kjo pjesë, se m'u dok shumë interesant, tregimet e gjyshërve që i përmendët, qe jeni rritë me tregimet e gjyshve, po m'duket shumë interesant, nëse mundeni me na tregu ma detajisht?

Abdullah Zeneli: Po...

Aurela Kadriu: Çfarë mbani n'mend prej këtyne...

Abdullah Zeneli: Kjo, kjo çashtja e... Populli shqiptar osht' shumë interesant, deri sa u është pamundësuar shkolla, shkrim-leximi, është pamundësuar disa mundësi tjera që kanë pasë shtetet për rreth. Mos t'harrojmë edhe urdhëresat e perandorisë Osmane që nuk kanë lejuar shkollat shqipe, edhe nja 1912-ta që i kaloj Kosova një territori krejt tjetër padrehtësisht. Kanë ndikuar që të krijtohet domethanë një gjendje çuditërisht e papërballueshme, po ja populli arrinë t'a tejkalojë këtë.

Edhe gjithë filozofinë e jetës, gjithë, si t'them, interepretim e çfarë po ndodhte duke ua përçar gjeneratave të reja ishte përmes filozofisë të disa gjerave që, filozofisë të rrefimeve që i kishim nga gjyshërit. Dhe natyrisht, osht' një ndër popujt e rrallë, populli shqiptar që ka arritur... Se unë, bie fjala filllet e letërsisë botërore që i kemi nga "Iliada" dhe "Odiseu", unë i kam dëgjuar përmes rrëfimeve t'gjyshit. Edhe pse ai, nga babai ka qenë analfabet, se nga nana thashë kishte formim shkollor, njëfte edhe filozofinë, njëfte edhe shkrim-leximin. Kishte natyrisht alfabetin e atëhershëm osman, jo arab po osman. Edhe kishte bibliotekën shumë t'pasur me literaturë edhe...

Mirëpo ajo periudhë ishte e vështirë, mos t'harrojmë ishte periudha e Aleksandër Rankoviçit. Edhe ai hezitonte t'i thoshte të gjitha gjërat troç sepse nuk lejohej, dhe të shkonte koka si thojnë. Unë habitem

se si kanë arritur që atë periudhë tepër vështirë të apart-heidit që ekzistonte, që të tejkalohet. Dhe nepërmes rrëfimeve, nëpërmes filozofisë, nëpërmes metaforave, figuracionit arrinte që të tregonte që duhet punuar natë e ditë, ta largonim djallin nga shtëpia. Sepse nuk është vetëm në aspektin fetar djalli, filozofia fetare shumë lidhet me filozofinë pragmatike. Edhe në këtë drejtim ne arrinim që t'kapnim këto momente.

Aurela Kadriu: Çfarë figurash letrare, çfarë metaforash...

Abdullah Zeneli: Po si largohet djalli, si duhet luftuar djalli. Se si duhet t'pasur mençuri të largimit t'djallit, t'keqës. Për ta luftuar t'keqen, për ta parë t'keqën. Edhe domethanë këto nëpër mes rrëfimeve dhe përallave që jonë çuditërisht, ose i sajnin ose barteshin brez pas brezi. Edhe, edhe si duket edhe kjo ka ndikuar që të zhvillohet imagjinata, të drejtohem nga letërsia, të shkruaj tregime, të shkruaj letërsi. Unë kam arritur që...

Aurela Kadriu: A mbani n'mend ndonjë prej atyne përrallave?

Abdullah Zeneli: Po përalla... Përshembull mitin e Odiseut, Ciklopit unë i kam, nga gjyshi i kam... Domethanë kam qenë shtatë, si kom pasë as shtatë vjeç ku i kam mësuar këto. Njeriu me një sy, se si shkon natën e gjithë ato. Domethanë rrëfimi i Odiseut, e kam dëgjuar nga gjyshi për herë t'parë. Kur e kam lexu "Iliadën" më vonë, habitesha se si gjithë ato thërmija të "Iliadës"...

Kjo tregon një gjë shumë interesante, se tash edhe në aspektin shkencor, tregon që fillet ne i kem pasë nga një kulturë shumë e zhvilluar. Të cilën pastaj me dyndje të mëdha, me sulme të mëdha, me pushtime të mëdha, me lufta të mëdha, osht' shkatërruar edhe... Mos t'harrojmë, ka pasë edhe periudha të epidemiv, ka pasë periudha të tërmeteve, ka pasë periudha që është shkatërruar një qytetërim. Edhe gjithçka e filozofisë është bartur gojë pas goje, gjeneratë pas gjenerate.

Kështu që thërmijat e t'gjithë krijimtarisë të antikitetit, të letërsisë greko-latine, për shembull unë thërmijat e tyre i kam dëgjuar nga rrëfimet e gjyshit edhe, të dy gjyshërve domethanë. Edhe, natyrisht edhe t'odave, që ka qenë një filozofi krejt sepse ndodhte për raste t'ndryshme edhe nga qyteti shkonim në fshat. Kur kishte ndonjë dasëm, ndonjë rast i veçantë. Dhe ka qenë ai rregulli i odës, dëgjohej njeriu i meçëm, rrëfimet e këtij, përvojat e këtij. Dhe ne si fëmijë rrinim atje një kand, diku pas dere dhe ishim krenar që na krijohej mundësia të dëgjonim t'gjithë atë mençuri që shprehej... Faktikisht ishin ato universitetet, n'atë kohë, odat.

Ju e dini, Anton Çetta ka bërë mbledhjen e folklorit të Drenicës, dhe po ta studiosh mirë, osht' një filozofi e jashtëzakonshme. Me fjalët e urta, me kash-e-lashtet... Për shembull në netët kur, atëhere s'kishte drita elektrike, nata fillonte herët, se di ta tejkalosh natën. E në errësi tregoheshin kash-e-lashtet t'ndryshme, lojëra t'ndryshme, rrëfime t'ndryshme, domethanë gjëgjëjeza. Ishte një botë që duhej ta plotësoje vakumin domëthanë, ta plotësoje kohën. Sot me *Facebook* ato i kalojmë domethanë. Ti je n'gjendje krejt botën brenda pesë minutave t'a kalosh.

Atëhere jeta ka qenë ma e ngadalshme. Po edhe në atë ngadalsim ka pasë plotëni domethanë. Ka pasë, e plotësoje jetën me këto rrëfime, me këto ngjarje, me këto zhvillim t'fantazisë. Kështu që unë kam pasë fatin që t'jem n'familje që ka qenë një zhvillim i tillë, i hovshëm, i madh i krijimtarisë dhe i rrëfimitarisë së gjenit t'popullit si thuhet. Dhe nga kjo si duket kam marrë edhe frymëzet që në punë duhet të jesh patjetër i suksesshëm dhe ta kërkosh suksesin. Ta gjurmojsh, të ecësh pas suksesit. Ose t'bësh diçka t'vleshme për popullin tënd. Fillimisht për familjën, për rrethin dhe për popullin.

Dhe natyrisht, për shembull, mbaj n'mend nga Shkolla Normale, po edhe nga shkolla fillore, orët letrare, hartimet e mira, rrëfimet e bukura. Dhe aty e sheh kur kontrollon arsimtari dhe habitet me atë që ke shkruar dhomethanë. Edhe vjen arsimtari thotë, "Kush osht' filani këtu?" "Pse?" Thotë, "Po ke një hartim shumë t'mirë. Ke saju do fjali t'bukra..." Po ai ishte rezultat i një përvojë të gjyshërve, një përvojë të fshatit, një përvojë të qytetit, kur vija dhe shihja...

Edhe ato përshkrimet bie fjala, kur rrënohej gjoja në emër të ndërtimit të ri, rrënohej e vjetra, që ishte... Ishin gjëra shumë t'bukra, ishin artizanatet, Prishtina ka pasë t'jashtëzakonshme në vitet e '50-ta.

Aurela Kadriu: Në cilin vit? Në cilin vit?

Abdullah Zeneli: 1956, përshembull. Tri, pesë vjet para se të ndërtohej, për shembull përmendorja që osht', kjo Trekandëshi që quhet.

Aurela Kadriu: A na tregon, në fshat keni jetu në bashkësi. Në Prishtinë a keni lëvizë gjithë familja, në bashkësi?

Abdullah Zeneli: Natyrisht ardhja në Prishtinë fillimisht ka qenë në një dhomë me qera, ishim t'vegjël. Unë isha domethanë, unë dhe motra ime ma e madhe. Unë jam më i madhi prej djemëve, edhe vajzat pastaj më vonë që lindën. Domethanë isha fëmija i dytë në familje. Dhe kur erdhëm në Prishtinë ishte një dhomë e vogël, e mbaj n'mend si sot. Dikun atje mbi hekurudhë.

Dhe nja pesë-gjashtë muaj kem pasë qëndruar në atë shtëpi. Ka pasë disa probleme te qiragjiu, ka ndodhë një vjedhje aty. Ne ishim n'fshat për një ceremoni, për një darsëm ose diçka. Edhe vijnë policia në fshat, kërkojnë çka ka ndodhë. Dhe unë jom lemeritë si fëmijë, domethanë kam qenë shumë i vogël n'atë kohë, pesë-gjashtë vjeç. Jam tmerru nga policia. Edhe sot e kam pikëpyetje a kanë ardhë ata për shkak të vjedhjes që ka ndodhë në atë shtëpi, a kanë ardhë për shkak të aksionit të armëve. Sepse nuk donin të na frikësonin prindërit për shkak të problemeve politike që ekzistonin në atë kohë.

Dhe mos t'harrojmë, une po e përmendi një diçka shumë interesante, e kam theksuar edhe në fillim. Ardhja ime në Prishtinë në atë moshë, flitej shumë edhe turqisht flitej. Ajo ishte një lloj, ishte një lloj zhargoni. Dhe krejt qëllimi ka qenë të humbet identiteti shqiptar, domethanë kjo ka qenë lojë e pushtetit. Edhe ka pasë një lidhje me një familje, halla e babait tim, domethanë motra e gjyshit ka jetuar në Prishtinë atë botë. Dhe djemt ajo i kishe shumë vizionar, ishin tapet të UDB-së, edhe në vitin 1962 jonë larguar nga Kosova, kanë shkuar në Turqi.

Edhe dej në vitin 1962 kam ditur t'komunikoj turqisht pak a shumë. Sepse m'interesonte lagjia, çfarë flitnin. Besa edhe na shanin neve që vinim nga fshati, na përbuznin nga pak. Nuk trajtoheshim si duhet. Dhe duhet përbulluar, edhe e vetmja mundësi ishte me kulturë, me lexim, me elegancë t'i tejkalojmë ato manire që i kishte krijuar familjet konvencionale këtu në qytetin e Prishtinës. Po nuk shkoi shumë kohë, dhe ndërroi e tëra. Shumë shpejtë ndërroi.

Aurela Kadriu: A erdhët në Prishtinë mandej si familje nukleare, vetëm ju dhe prindërit?

Abdullah Zeneli: Vetëm familja e thjeshtë e prindërve të mij. Edhe mandej kem kalu, kem lëvizë nga një lagje në lagje. Bie fjala deri tash janë ndërruar pesë shtëpi. Edhe çuditërisht vuaj nga një mungjesë e shokëve të fëmijërisë. Sepse nëqoftëse i ndërron pesë lagje të ndryshme, krejt t'ndryshme, tamam e krijon një shoqëri, kalon në lagje krejt tjetër, ajo shoqëria mbetet...

Aurela Kadriu: Cila ishte ajo lagjia e parë...

Abdullah Zeneli: Lagjia e parë ka qenë mbi hekurudhë. Kolonia e Re quhej atëherë. Ka pasë pak shtëpi atje mbi hekurudhë. Edhe...

Aurela Kadriu: Çfarë lagje ka qenë kjo?

Abdullah Zeneli: Lagjia e të ardhurve, Kolonia e Re quhej. Bile, bile habiteshim quhej edhe me terma serbisht *Nova Kolonija*, Kolonia e Re. Domethanë ishte mbi hekurudhë atje, mbi urën që shkohet për Podujevë atje. Ka pasë pak shtëpi andej. Edhe pastaj te shkolla fillore "Meto Bjraktari" ka qenë e treta. Pastaj tek tregu i perimeve që quhet, një periudhë nantë vjeçare. Prej aty, tash ku jom...

Aurela Kadriu: Në Ulpianë?

Abdullah Zeneli: Jo. Te tregu i ri, te tregu i perimeve. Te tregu këtu, te tregu kryesor që është i Prishtinës. Te televizioni. Domethanë une e mbaj n'mend atë pjesë krejt ndryshe ka qenë. Edhe disa pjesë të televizionit që jonë, jo vetëm te qendra e televizionit, por edhe në pjesën tjetër... E mbaj n'mend edhe një treg ka qenë aty, një hapësirë krejt e tregut. Ndryshe ka qenë ai treg i organizuar. Po flas gjithmonë për vitet 1957, '58, '60 bie fjala. Edhe mandej n'atë pjesë ma vonë ka qenë edhe stacioni i autobusëve. Pikërisht ku osht' ajo pjesa e tregut, mes televizionit edhe tregut. Ka qenë...

Aurela Kadriu: Cilat vite ka qenë stacioni i autobusëve?

Abdullah Zeneli: Ka qenë diku prej '67-'68 deri dikun '77-78, po.

Aurela Kadriu: Në cilat lagje u vendosët mandej?

Abdullah Zeneli: Mandej në Taslixhe, ku jom edhe sot. Domethanë një lagje krejt e re, Taslixhja s'ka pasë as një shtëpi kur shkonim në shkollën Normale. Bile kishim frikë të kalonim natën andej se ishte shkretinë, s'kishte asgja te ajo pjesë.

Aurela Kadriu: A na tregon për këtë lëvizje nëpër qytet? Ju paska ra me përjetu...

Abdullah Zeneli: Po, po. Kjo tregon, po them mua m'ka lanë pak komplekse sepse mungesa e shokëve të fëmijërisë është e çuditshme domethanë. Po unë këtë e kam plotësuar, si ju thashë ma heret me librin. Libri është, mi ka plotësuar të gjitha mungesat e shoqërisë, mungesat e... Sepse njeriu ka gjithmonë mungesa, mungesa edhe materiale, ka mungesa t'ndryshme. Të mos zgjerohem në filozofinë e një fëmiju i cili është pak a shumë me kërkesa. Se nuk është e lehtë të jesh biri i një minatori dhe t'përballesh me diferencat e mëdha, qoftë të zhvillimit, ose prejardhjes, ose ku ta di unë.

Edhe e kam plotësuar këtë me librin. Me jetën e personazheve t'librit unë bashkëjetoja domethanë, edhe njihesha mirë me një personazh të Nju Jorkut, një personazh të Amerikës, një personazh të Australisë. Me Robinson Kruzon i vetmuar atje ku ka jetuar edhe e ka plotësuar jetën domethanë. Kam lexuar atë kohë shumë libra, edhe të udhëpërshkrimeve, të avanturave, të lëvizjeve nëpër detra. Domethanë jetën e detit e kam mësuar nga librat dhe knaqesha me librat si "Ishulli i Koraleve", ose...

Kanë qenë disa libra të një udhëpërshkruesi hungarez, një Tibor Sekelj. E avanturat në Amazoni i kam lexuar nga ai. Domethanë atë, atë botën e Indianëve, e njerëzve që kanë, domethanë e fiseve t'ndryshme që jetojnë në ato xhunglat e ndryshme e Amazonës. Domethanë une si fëmijë dhjetë-dymbëdhjetë vjeç i kam përjetuar ato gjëra dhe ishte diçka e jashtëzakonshme. E sheh botën domethanë shumë ma shpejtë, si sot që janë rrjetet sociale, ne i kishim ata libra.

Ose një titull shumë interesant, "Ku nuk ka mbërri qytetnimi" për shembull, pikërisht i këtij Tibor Sekelj, një aventurier shumë interesant. Ose "Kon-Tiki" i Thor Heyerdahl. Ai ka qenë një aventurier që ka bërë të pamundurat nëpër oqeanë, të shikoj a ka pasë mundësi njeriu me një anije të drurit të shkojë nga një kontinent në kontinentin tjetër. Domethanë janë gjëra me t'cilat unë e kam plotësuar veten me këto aventura në moshën shumë t're. Jam ndje shumë mirë, jam ndje komod. E kam plotësuar atë që mungonte, e kam plotësuar mungesën e shokëve, mungesën e një paraje që ka dëshirë njeriu ta shohë, ose...

Pastaj edhe një botë tjetër është kërkesa shumë e madhe ose dëshira shumë e madhe jonë që t'shohim film. Atëhere bëhej tollovi e madhe, këto kinematë që kemi pasë. Domethanë, Kinema Rinia, Kinema Vllaznimi dhe Kinema e Armatës Popullore, APJ që quhej.

Aurela Kadriu: Ku kanë qenë këto kinema?

Abdullah Zeneli: Kinemaja Vllaznimi ka qenë te ABC-ja që osht' sot. Kinema Rinia osht' këtu përballë këtu {tregon me dorë nga dritarja}, përballë Qafës. Ndërsa APJ ku ishte UNMIK-u. Edhe tash m'duket e kanë rihapë. Rastësisht qëllova një ditë kur pashë disa njerëz aty dhe m'erdhi mirë. E mbaj n'mend shumë mirë dhe atë kinema. Dhe mbaheshin nganjëherë, na çonin edhe koncerte të ndryshme frymore, të instrumenteve... Edhe shfaqje të ndryshme teatrale. E kam ndjekë edhe si fëmijë teatrin. E kam dashur shumë.

Aurela Kadriu: Çfarë filma shfaqeshin në atë kohë...

Abdullah Zeneli: Po filma faktikisht farë, farë... Krijimet më të mira dhomëthanë botërore vinin. N'atë kohë ka qenë interesante ato aventurat e indianëve. "Vinetu" përshembull ka qenë. "Vinetu" le që e kem përcjellë n'film, po ka qenë edhe një adaptim teatral. Po mbaj n'mend edhe një diçka shumë interesante të asaj peridhe. Bie fjala kur kam kalu një ditë qytetit edhe kam pa një reklamë, shfaqet "Tratufi" në vitin 1962, unë kom qenë njëmbëdhjetë vjeç atëherë. Shkoj blej biletën edhe kom shku e kom pa shfaqjen. Dhe m'ka interesu domethanë "Tartufi" i Molierit, shekulli i 17, mesi i shekullit të 17... Ato floket e gjata {bënë me duar gjoja se prekë flokët e gjata} domethanë të atyre aristocracisë franceze. Edhe për mu ishte një botë krejt e re, shumë interesante. Ndoshta është edhe priudha edhe e *Beatles* dhe unë kam kriju njëfar lloj adhurimi ndaj flokëve të gjata dhe nga ajo kohë unë i kam flokët e gjata (buzeqeshë).

Pjesa e Dytë

Abdullah Zeneli: Dhe ato vitet '60 që n'fakt janë, janë vitet '61, '70 për afërsisht kjo periudhë domethonë është, është periudha vlimet e mëdha, qoftë të trendeve muzikore, qoftë filmave. Po kam pasë fatin e mirë që kam pa shfaqje shumë të mira në teatrin e Prishtinës, edhe atë brezin e aktorëve shumë të mdhej unë i kam pa si fëmijë. Katarina Josipi bie fjala ka qenë e jashtëzakonshme dhe e kam, e kam ndjekë edhe Radio Prishtinën, kishte adaptime për fëmijë Radio Drama, për fëmijë çdo të diele ka qenë në mëngjes në orën tetë. Edhe e dëgjojsa me pasion domethonë ka qenë diçka e jashtëzakonshme. Pastaj edhe orët gazmore që kanë qenë një humor kam adhur... jam adhurues shumë i madh i humorit, i satirës sepse me humor dhe satirë njeriu e plotëson vetën, krijon një optimizëm.

Aurela Kadriu: Çfare ka qenë humori në atë kohë? A në radio...?

Abdullah Zeneli: Po në radio, ka qenë shumë interesant ora gazmore ka qenë çdo ditë... Çdo të diele ka qenë në mbramje ora gazmore, Mixha Ramë që quhet ai Fitim, Fitim [Fitim Domi]...

Aurela Kadriu: Cilat vite?

Abdullah Zeneli: Po nga viti '67, '68 derisa u mbyllë radioja, domethënë kohën kur hynë masat. Ka qenë ora gazmore, radioja ka pasë edhe pika tjera të shumta t'randësishme. Ka pasë variacione poetike, ka pasë radio dramën, radio dramën e ka pasë nëqoftëse nuk gaboj çdo të enjte ose premte. Po është dhe "Variacione Poetike" një emision, ka pasë edhe këndimin leximin e përralla për fëmijë, i dëgjojsa me pasion. Ka qenë për vite të tëra Safete Rogova ka lexuar në mënyrë të mrekullueshme ato përallat për fëmijë ka ora tetë e mbramjes, që faktikisht i vënin në gjumë fëmijët. Sikur që ishte trendi atëhere me filmat vizatimorë para lajmeve që fëmija i shikojnë edhe bien n'gjumë.

Natyrisht dalja e televizionit bardhë e zi ishte, ishte ngjarje e jashtëzakonshme. Po përpos teatrit edhe filmit mua më kujtohet shumë mirë në Normale kur ishim e pata lexuar "Luftën dhe Paqen" siç thashë

edhe ma herët. Edhe... është bërë film “Lufta dhe Paqja” dhe ishte tollovi e madhe për ta parë dy vazhdime domethanë, një realizim rus por i jashtzakonshëm. Edhe faktikisht zbërthimin e asaj, katër vëllimeve të romanit e shihje në dy pjesë të filmit, dy pjesë të filmit diçka e jashtëzakonshme domethanë, një gjenialitet i të shkruarit të Tolstoy-it. Ajo hidhej në, në si t’them në ekran për ta parë, diçka ndër arritje më të mira ose mrekullitë më të mira që kam parë si nxënës i Normales në aspektin e ekranit ka qenë pikërisht Lufta dhe Paqja. Natyrisht ka pasë edhe filma tjerë po që kanë mbetë në kujtesë sepse është një, një përballje Napoleoni, lufta diegija e Moskës ato personazhe Natasha, Andrei, Pierre Bezukhovi. Domethënë është, janë gjëra të jashtëzakonshme që mbesin në kujtesë dhe formojnë, e sheh ku është bota, e krijon një vizion të përplasjeve, luftave, viktimave të topave, t’kalljes krejt qytetit të Moskës.

Strategjisa Kutuzovit, bie fjala gjenerali rus, si e mashtron, një, një gjeni të luftës siç ka qenë Napoleoni, e kshtu me rradhë. Domethanë janë segmente të cilat dalëngadalë e krijojnë at mozaikun e formimit të një personaliteti ose njeriut i cili kënaqet me arritjet në fushën e artit siç janë. Siç thashë teatri, filmi, libri që është në vend qendor libri. Por edhe pjesët tjera, artet figurative bie fjala, Kosova ka pasë atëherë piktorë të jashtzakonshëm siç ka edhe sot. Piktura duhet të avancohet sepse piktura mundësi si ndër artet e rralla, krahas muzikës kompozimit, domethënë pjesëve muzikore, ska nevojë t’përkthehen. Janë shumë të lehta për të ardhë deri te receptuesi, deri te konsumuesi, domethënë te ai që i përjeton i sheh nëpër galeri të ndryshme, pikturat nuk ka nevojë të përkthehet ajo çka është është, shihet vizualiteti.

Në atë kohë kom pasë arsimtarë shumë t’mirë në shkollën Normale në fushën e artit, një Engjëll Berisha që ka qenë, Kadrush Rama, Sylejman Cara domethanë kanë qenë të formatit të piktorve aso kohe shumë, shumë interesant. Edhe këto pjesët e ndryshme të artit e kanë plotësuar domethanë atë mozaikun siç thashë të kënaqësisë estektike që duhet ta përjetosh qoftë në imagjinatë, qoftë në realitet që duhet ta shohësh për çdo ditë.

Aurela Kadriu: Qysh na i kishit përshkru ju personalisht këtë përvojën me jetu në mes të dy realiteteve, të atij realitetit fizik edhe të atij realitetit të librave?

Abdullah Zeneli: Po këtu është, këtu është esenca e pakënaqësisë që ka njeriu me disa rrjedha që ndodhin, që ndodhin në jetën e tij se gjithmonë nuk shkoj vaj, gjithmonë nuk shkon mirë. Ka momente t’vështira po ato duhet të plotësohen me këtë pjesën tjetër. Domethënë sepse nganjëherë edhe në jetë na ndodhin skena surrelae që s’i kapë mendja e njeriut. Ndodhin momente pikëllimi, momente t’vështira, momente të pakënaqësisë dhe ato natyrisht njeriu duhet t’jetë, shumë, shumë pragmatik edhe ta plotësojë jetën. Ta plotësojë jetën me shoqëri, me atë që të ofrohet, me teatrin, me filmin, me t’gjitha. Me jetën e lirë, në kuptimin me gjitha. Unë çuditërisht nuk i kom pasë dëshirë kurrë pushimet edhe nuk di çfarë është pushimi domethanë sepse unë pushoj në fakt duke lexuar, duke punuar, duke arritur domethënë atë gjithmonë që kam në mendje. Edhe kjo, kjo më sjellë kënaqësi.

Tani jam plakë, kjo është moshë e kapërcyer të them, kam kaluar në pension, shoh plotë suksese të brezit tim, shoh suksese të popullit tim. Nuk është më ajo diktaturë e tmerrshme që ka qenë, që ka

qenë qoftë në Ish-Jugosllavi, qoftë në Shqipëri. Dhe natyrisht nuk duhet pritur nga shteti, duhet t'ketë inicativa, duhet të ecët përpara, duhet t'keshë vizonin dhe të punosh për atë vizion. Në qoftëse nuk punon për atë vizion s'ke bërë asgjë, s'ke bërë asgjë. Dhe këtu është e mira e realitetit dhe në, gjithë diverzitetin që ka Ballkani, këtë, si t'them kulturë përplaje të kulturave, ka vend gjithmonë për mirë, ka vend për ta respektuar tjetrin, për ta dashur tjetrin. Edhe si duket edhe kjo ka ndikuar që t'i dua letërsitë.

Lexoj pa komplekse edhe letërsi serbe, lexoj edhe letërsi të popujve përreth, letërsi greke, turke bie fjala. Po natyrisht qendrën e të gjitha letërsive e kom letërsinë franqeze, letërsinë anglo-amerikane pa i shmangë edhe letërsitë tjera që janë shumë të mëdhaja. Bie fjala letërsia spanjolle, me Don Kishotin është e pazavendësushme, është një kënaqësi e madhe që e kam lexuar si normalist bie fjala, e shumë e shumë letërsi tjera. Edhe letërsia ruse që përmenda që në fillim, letërsi shumë e madhe se në shekullin 19 është e jashtzakonshme, me Tolstoy, me Dosojevskin, Pushkinin, e adhuroj Pushkinin...

Aurela Kadriu: E paskemi një të përbashkët, edhe unë e du shumë Pushkinin.

Abdullah Zeneli: I jashtëzakonshëm, "Eugen Onjeginin" e kom pasë dhuratë si libër në vitin e parë të shkollës Normale, është përkthimi brilliant i Lasgush Poradecit, Lasargushi. Bile shkruan përkthyes është diçka e jashtëzakonshme edhe domethanë kjo e plotëson njeriun, njeriu duhet ta gjejë vetën, duhet t'shoh çfarë, çfarë i mungon edhe ta plotësoj atë mungesë.

Aurela Kadriu: A na tregoni për shkollën fillore, në cilin vit keni filluar shkollën fillore? Edhe çka mbani mend prej asaj periudhe?

Abdullah Zeneli: Po është viti 1959 domethanë une kam pasë shumë afër shkollën, edhe, edhe çudi e pata fillu shkollën njo dy javë me vonesë se kishte një aktivitet ose kishte një diçka në fshat atje edhe mbas dy jave edhe ishte diçka krejt e re. Ai rrethi i ndryshëm, nxanësat e ndryshëm lagjeve t'ndryshme edhe... Po une e kam pasë një fat të çuditshëm, në klasën e parë më janë ndrru disa mësues edhe faktikisht si mësuese të parë, e kom mësuesen e klasës së dytë. E njoh, mbamendje kшту kom pasë fatin e mirë që ka qenë një mësuese e jashtzakonshme, i detyrohem shumë Bakize Brovina. I detyrohem shumë, i ka vrejtë prijët e mija për letërsi, prijët e mija për ta shkëputur jetën fshatareke dhe për t'u shëndrruar në diçka tjetër. Edhe ato finesat që e karakterizojnë një qenie, ajo i ka vrejtur, i detyrohem shumë, shumë arsimitares sime, mësueses sime, që e konsideroj si mësuesën time të parë Bakize Brovina.

Pastaj, pas asaj janë katër klasë tjera në "Elena Gjika". Edhe atje janë, janë vrejtur prirjet qoftë për letërsi, qoftë për matematikë. Ka pasë mësuese, Fahrije Shitën ka qenë e tmerrshme në kuptimin e kërkesave por hallall si thuhet një mijë herë, sepse ka arritur që të ngulitë te nxënësi prirjen e njohjes së matematikës. Sepse matematika sot në qoftëse jam i sukseshëm në veprimtarinë time botuese është duke ju falenderuar njohjes së shkëlqyer të matematikës. Dhe artet tjera ose gjuha shqipe me Vedihate Mqiun që e kom pasë një arsimitare t'jashtëzakonshme në gjuhën shqipe...

Aurela Kadriu: Çfarë sistemi ishte ky që i bartë katër klasë në "Meto Bajraktari"...

Abdullah Zeneli: Eh nuk ka pasë, pas katër viteve domethanë nuk ka pasë shqip në “Meto Bajraktari”. Duhej paralelja shqipe t’shkonte në “Vuk Karagjiq”, ose “Elena Gjika” sot që osht’. Ndërsa paralelja turke e vazhdonte të pestën-gjashtën këtu në “Meto Bajraktar”. Domethanë bahej ky ndërrim. Edhe kalimi atje ishte diçka krejt ndryshe. Une pak e kam një handikap që e përmenda edhe më herët, ajo periudha e kryrjes t’fillores. Krejt klasa ime, pothuajse shumica shkuan në gjimnaz, unë isha i vonuar për shkak t’problemimit që kisha me shkollën e mesme të zanatit në Obiliq, që e tradhëtova babin tim, po ma ka falë atë tradhëti. Edhe Normalen, Normalen natyrisht kom qenë një ndër nxënësit ma t’mirë...

Aurela Kadriu: A shkove në Normale menjihere mbas fillores?

Abdullah Zeneli: Mbas fillores, sikur n’shkollë t’mesme konkurron, provime pranuese. Edhe bile, bile m’kujtohet ishte moment i fundit që zura konkurimin, sepse kisha shkuar në këtë shkollën e zanatit...

Aurela Kadriu: Çfarë zanati...

Abdullah Zeneli: Po ishte një zanat, atëherë minierat, ishin fillet e termocentratit, ju duheshin zanat të këtyre mekanikëve të ndryshëm, çka po di une, me hekur me punu... Nuk është punë nënçmimi, por unë isha i botës t’librit. Isha formuar, isha formuar me teatër, isha formuar me bibliotekën, isha formuar me t’gjitha. Edhe t’kaloja në një profesion që nuk m’jepte knaqësi ishte diçka për mu tragjedi.

Edhe e tradhëtova babain tim, gjoja nuk arrita ta kaloj provimin pranues, bëra dokumentet dhe i çova në Normale. Sepse ishte e vetmja normalja të hapun ende, domethanë afati i hapur. Edhe kur hyra, po e them ndoshta pa modesti, kur dolën temat qoftë në gjuhën shqipe, qoftë në matematikë, unë pas pesë minutave i kam çu përgjigjet. Edhe arsimtarët që na kontrollonin, që na mbikqyrnin, mendonin që unë po e lëshoj demonstrativisht. “Jo, i kom kry!”

Domethanë nga ekstremi i moskryerjes kalova në ekstremin tjetër, për pesë minuta edhe gjuhën shqipe edhe matematikën. Edhe mandej Normalja s’kishte problem, domethanë ata që m’kanë pasë n’klasë ose n’brez e dijnë çfarë kontributi kom dhanë n’shkollën Normale.

Aurela Kadriu: N’cilin vit keni shku në Normale?

Abdullah Zeneli: 1967-68, viti i parë shkollor. Domethanë para pesëdhjetë vjetëve...

Aurela Kadriu: Ku ka qenë shkolla?

Abdullah Zeneli: Normalja osht’ sot te Gërmia që shkohet atje, domethanë Unversiteti Amerikan, eh kjo pjesa tjetër. Dikur mandej u shëndrru në diçka tjetër. Edhe dikur ishte edhe gjimnazi i... Nuk e di se si...

Aurela Kadriu: I gjuhëve.

Abdullah Zeneli: I gjuhëve, po, “Eqrem Çabej”. Pastaj u zhvendos, tash për momentin çfarë është nuk e di, nuk e di. E di që osht’ AUK-u andej.

Aurela Kadriu: Qysh e mbani n'mend?

Abdullah Zeneli: Ajo Shkolla Normale ka qenë tempull i madh i dijes, në atë kohë. Ka qenë me autoritet, ka pasë arsimitarë shumë t'mirë, tepër t'mirë. Ka qenë edhe një lloj çerdhe e nacionalizmit. Aty janë ngjizur të gjitha kuadrat, si me thanë, edhe kanë, shumë e kanë, personalitete t'mdhaj që janë formuar e kanë kryer shkollën Normale në atë kohë. Edhe kjo ka bërë që t'kesh përgjegjësinë dhe t'jesh i dobishëm për shoqërinë. Edhe pothuaj se për çdo ditë vinte policia atje. E mbaj n'mend shumë mirë. Në të '68-tën përshembull, demonstratat...

Aurela Kadriu: A na tregon ma shumë për këtë pjesë?

Abdullah Zeneli: Ajo pjesa e 27 nëntorit ka qenë e pabesueshme, se si u alarmu krejt kolektivi, krejt arsimitarët, u ndal rryma. Domethanë detyrimisht ne duhet t'vinim edhe t'i bashkangjitemi turmës se demonstrimit. Dhe kanë bërë shumë arsimitarët, ata që kishin një vizion që t'na ngjiznin me idetë e Rilindjes kombëtare, me idetë patriotike. Pavarësisht se ato ku e ku familjet i kishin, pak a shumë ishin të formuara siç thashë edhe më herët për frymën e Kongresit të Manastirit, ose për t'gjitha ato.

Por ndryshe osht' kur bashkimi ban fuqinë, kur ishim... Di raste plotë kur na kanë marrë përgjegjësi pse është rrëxuar fotografia e Titos, pse është bërë ndonjë dëm tjetër...

Aurela Kadriu: A na tregon për qato raste...

Abdullah Zeneli: Ka pasë plotë raste. Edhe përpiqeshim të zbulonim kush e ka bërë, si e ka bërë. Por ka pasë një harmoni e madhe n'mes t'nxënësve, ka qenë e pamundur për ta zbuluar kush e ka bërë atë veprim. Domethanë ishte faji kolektiv. Fajin kolektiv s'mund ta dënonin, kështu që kalonim pa pasoja.

Edhe lexonin, atëherë filluan t'vijne edhe librat nga Shqipëria, libra t'ndryshëm, ishte një letërsi e madhe. Ishte një rilindje, faktikisht një rilindje kombëtare përmes atyre librave. Kalojshin dorë më dorë. Mbaj n'mend edhe leximin e librit që atëhere ka qenë *best seller* "Tradhëtia" e Kapllan Resulit. Ka qenë një ibër që s'ka pasë njeri që se ka lexu atë libër. Edhe ma vonë mandej degjeneroj, e dini ju se si kanë ecur punët, nuk po futem në këtë kapitull.

Por normalja ka qenë një formim i jashtëzakonshëm në aspektin nationalist. Nacionalist në kuptimin e mirë, se jo në kuptimin... I kërkimit të të drejtave që na mungonin. Unë mbaj n'mend një padrejtësi e madhe që më është bërë atë botë në shkollë Normale. E kishim një zvendës drejtor i cili ishte i ngarkuar, serb ishte, ishte shumë i ngarkuar. Bile në qoftë se nuk gaboj mbiemrin Kostanoviq e ka pasë. Ai nga një muaj para se t'vinte dita e shkollën, se shkolla quhej "Miladin Popoviq", dëshironte ta nderonin, apo ta vlerësonin... T'i jepnin një mirënjohje nxënësit që ka lexuar më se shumti libra në bibliotekë.

Edhe shkon te bibliotekisti në mënyre zyrtare ta kërkon listën e lexuesve më të mirë. Ai ishte i sigurtë që është një lexuese apo lexues serb. Ishte i sigurtë. Kur e ka marrë që une, atë lexuesin potencial serb ose serbe e kaloja me nja tridhjetë libra, edhe e stopoj, nuk u dha çmimi. Këtë disi, m'ka mbetë në kujtesë si padrejtësi tepër e madhe që më është bërë. Aty e kam pa sa, n'vend që të reflektojë, qoftë edhe ai

zavendës drejtor serb, të reflektojë sepse tek e fundit lexuesi është lexues. Lexuesi s'ka kombësi, lexuesi s'ka profesion.

Se unë zakonisht ju them lexues është edhe presidenti, lexues është edhe kryeministri, lexues janë edhe ministrat, lexues janë zyrtarët, lexues janë ushtarët, lexues janë policët... Domethanë lexuesi s'ka profesion. Edhe lexuesi duhet të vlerësohej ai që ka lexuar libra. Nuk m'u dha ai çmim. Edhe gjithmonë e kam peng, pse ndodhi ajo padrejtësi e madhe. Domethanë jonë këto momente që mbesin në kujtesë.

Po e kam tejkualuar. E kam tejkualuar sepse duhet dyfishuar... Deri sa dikujt nuk po i vika mirë që t'lexoj, atëhere do t'ja dyfishojmë, do ta dyfishojmë leximin. Edhe ia kom pa hajrin kësaj padrejtësie {bënë thonjezat me gishta} të them n'thonjëza.

Aurela Kadriu: A ka ndiku kjo në naj far mënyre me iu shty, me organizu ma shumë në luftën...

Abdullah Zeneli: Po sigurisht deri sa, deri sa, unë atë padrejtësi si të them e kisha nga gjyshi me të gjitha ato përjetime që i ka pasë. Një gjë është interesante, gjyshi im që ka qenë ushtar në, në, në Manastir 1908-1912 ka përjetuar Luftën e Parë Ballkanike, është zanë rob se ka dezertu edhe i kanë bartë me të burgosun e me të gjitha deri në Beograd. Edhe ka qëndruar një kohë të gjatë në Beograd. Çuditërisht vijnë forcat serbe ushtarake dhe futen në Kosovë dhe pjesën tjetër të popullatës kanë zanë rob. Nëqoftëse hyni në internet e kërkoni një marshi nëpër qendër të Terazijes të Beogradit në atë kohë, është një fotografi që e kanë bërë austriakët dhe shihet kolona e të burgosunve, anash policët, se si i çojnë nëpër burgje. Dhe çuditërisht gjyshi im e sheh pas disa ditëve stërgjyshin, babain e vet që s'e kishte parë katër vjet, edhe ai i burgosun domethanë, ky i zanë rob si dezertor në Luftën e Parë Ballkanike, me gjithë atë tmerr që ka përjetuar si i burgosur në Kalanë e Shkupit, në Nish e deri me trena sikur kafshët që i kanë ngarkuar, madje, madje thoshte dikur rreth tridhjetë përqind e asaj mase njerëzore kanë shkuar sepse të gjithë në rrugë e sipër janë sëmurë nga sëmuret ngjitëse si tifoja e zorrëve, tifoja e morrit e...E tmerrshme, domethanë këto rrëfime i kam nga gjyshi dhe e di se si e ndiente ai veten kur i thoshte këto. Domethënë neve na dukeshin si rrëfime, ndërsa ai i ka pasë përjetime reale, i ka pasë. Edhe paramendoni...

Aurela Kadriu: Stërgjyshi pse kishte qenë atje?

Abdullah Zeneli: Stërgjyshi, këtu është problemi...Sepse forcat serbe kur vijnë në Kosovë, edhe ata pak meshkuj që ishin i zënë rob...

Aurela Kadriu: Në 1912-tën?

Abdullah Zeneli: 1912-tën, shumë e çuditshme. Edhe e sheh e takon fare rastësisht, ai ka qenë një rastësi. E takon, domethanë gjyshi im e takon babain e vet i cili është stërgjyshi im, bile edhe ai e ka pasë emrin Zeneli nga e kemi edhe na mbiemrin.

Aurela Kadriu: A kishte ndodhë kjo për shkak të ngjarjeve në Shqipëri apo...

Abdullah Zeneli: Jo, jo, jo. Luftat Ballkanike, pushtimi i Kosovës në 1912-tën, natyrisht aty ka dorë edhe faktori ndërkombëtar atëbotë, se ju e dini ndarja e kufijve, mandej vjen...

Aurela Kadriu: Konferenca e Londrës...

Abdullah Zeneli: Konferenca e Londrës, ato të gjitha që kanë ndodhë...Edhe e tmerrshme domethanë ma vonë mas 1912-tës kur vijnë kolonitë, vijnë serbët e parë në fshat aty, natyrisht unë s'e mbaj në mend se unë kam lindë në '52-tën, po kem pasë fqinjë serbë, e tmerrshme çfarë serbësh kanë qenë, ata që kanë marrë pjesë edhe në këto masakrat që dihen, e Prapashticës e këto vendet...

Aurela Kadriu: Keni pasë komshinjë serbë në fshat apo këtu?

Abdullah Zeneli: Po, në fshat, në fshat. Edhe unë kam mësuar serbishten herët. Ju thashë edhe ma herët, unë kom ditë...

Aurela Kadriu: Çka keni përjetu prej tyne?

Abdullah Zeneli: Në fakt ata në fqinjësi ishin, ishin...Nuk mund të vëreje që kanë tendenca, por ishin pjesë e sistemit, pjesë e sistemit, pjesë e atij tmerrri që kemi përjetuar. Si thuhet, "Të shkuara, të harruara". Është, ajo është një periudhë shumë e çuditshme, po përfundoi për fat tek faktori ndërkombëtar.

Aurela Kadriu: Më interesoi, e përmendët që keni pasë një ndikim prej të ardhunve të Gjakovës kur keni ardhë në Prishtinë. Në cilën lagje ka qenë ky kompozicion?

Abdullah Zeneli: Është lagja te shkolla "Meto Bajraktari", në atë lagje kom jetu unë.

Aurela Kadriu: A ka qenë ky kompozicion kryesisht njerëz të adhur nga qytete të tjera?

Abdullah Zeneli: Nji lagje krejtësisht e re, e dini te shkolla domethanë përballë qafës dhe shkollës domethanë kanë qenë familjet më të njohura të Gjakovës, Brovina mbiemrin që jonë, Stavileci, Rudi, familjet tjera domethanë. Edhe kam pasë shokë edhe shoqe në atë kohë kam pasë shokë domethanë në familjen e Flora Brovinës, e kam njohtë Flora Brovinën që në atë kohë. Me nji motër të Flora Brovinës, Flutura Brovinën e kom pasë në klasë, me familje të tjera shumë domethanë aristokratike që kanë qenë në botëkuptimin e neve që vinim nga fshati, kanë qenë pjesë e nomenklaturës, ose pjesë e zhvillimit. Bija të kompozitorëve, bija të piktorëve, bija domethënë të drejtorëve të ndryshëm të emancipuar që kanë qenë, edhe ka qenë fat i imi që të jem në atë mjedis dhe natyrisht ajo ka ndikuar që unë të marr ato vetitë e mira të them edhe...mirëpo jam treguar shumë i shkathët, kam ecë ma shpejt pak, kam ecë pak ma shpejt, kam ditur të vjedh, sikur puna e bletës ta vjedh, ta merr nektarin. Kam qenë gjithmonë ambicioz kam qenë.

Aurela Kadriu: Në cilin vit keni vendosë me studiu matematikën?

Abdullah Zeneli: '71-'72.

Aurela Kadriu: Qysh vendosët me shku në matematikë?

Abdullah Zeneli: Po e kam ditë ma së miri në shkollë Normale e kom ditë matematikën. Matematikën e kom ditë kështu...Edhe sot, matematika është shpëtimtare se fundi i fundit çdo gjë në univers matematikë është.

Aurela Kadriu: A nuk e përjetojshit këtë si shkëputje prej librave?

Abdullah Zeneli: Jo, jo, jo. Ma ka ndihmuar, përkundrazi. Janë dy ekstreme që i kam përafruar, kam njohur shkëlqyeshëm vizatimin teknik, diçka e pabesueshme, artet figurative, simetrinë, harmoninë e këto...Këto jonë ligje të cilat, faktikisht si në letërsi që ka harmoni te figuracioni, te shkrimi, e njëjta gjë është edhe tek shkencat, ka një sistem, ka një rregull. Gjithmonë njeriu i cili arrin sukses di ta vetëdijësojë ose ndërgjegjësojë vetveten sepse din ta krijon harmoninë, nëqoftëse ti e krijon harmoninë që dera është dera, nga dera hyhet e jo nga dritarja, dritarja është për të parë botën, dritarja është për dritën, dritarja është për ajrin, dritarja është për këtë...Domethanë duhet të dish secilin objekt rëndësinë ose peshën e vet, ose dedikimin për çfarë e ka bërë njerëzimi domethënë. Edhe fati që ne nga breza kem arritur që në njëfarë mënyre t'i përballim ose t'i gërshetojmë edhe traditën e mirë të si të them, pasurisë së madhe të filozofisë, mendësisë së popullit edhe me letërsinë e përbotshme.

Unë kam pasë fatin që t'i shoh dhe t'i bëj bashkë që të dyjat, siç kam arritur edhe shkencën edhe letërsinë njisoj t'i dua dhe t'i përvetësoj, poashtu edhe këto të dyja. Shumë interesante, është një libër që ende nuk është botuar, unë e kam përkthyer të gatshme qe sa vjet "Retorik"-ën e Aristotelit, është një kryevepër që s'e kemi ende në shqip, edhe pse unë e kom të gatshme për botim. Çdo gjë është e thënë, edhe çudi e madhe ato që fliten aty unë i kam dëgjuar nga rrëfimet e gjyshit, domethanë është në nëndijen e popullit tonë që dikur kem pasë universitete, dikur kem pasë zhvillim, dikur kem pasë shkolla, dikur kem pasë pallate, dikur kem pasë jetë urbane shumë të zhvilluar.

Vjen fjala, vendlindja ime Sibovc është shumë afër lokalitetit shumë të njohur që e ka Kosova, Vendenisi për shembull. Edhe vetë kam shkuar i kam parë ku ka qenë për shembull rruga e shtruar e atij qyteti para dy mijë vjetësh. Edhe kam shkuar në kohën kur është gruri ende i papjekur, ende i gjelbërt, jeshil si thuhet. Edhe në një anë të ngjyrës së grurit kam vërejtur ku ka qenë rruga sepse i kisha rrëfimet që, "Ka qenë kështu, jo macat kanë shkuar nëpër mure, jo knej jo anej", dhe është pjesa shumë interesante e vegjetacionit dhe madje madje flitet edhe nga historiografia që në atë pjesë dikur duhet të ketë qenë një qytet jashtëzakonisht i madh. Ende diskutohet ku ka qenë qendra e Dardanisë, a ka qenë Shkupi a ka qenë Pre-Justiniana që quhet domethënë lokaliteti i Ulpianës apo ka qenë në atë zonën që është pjesa e Gallapit që quhet, ajo pjesë nuk ka vend po gërrmove që nuk gjendet diçka. Është një mister të cilin ma vonë arkeologjia do ta zbulojë.

Aurela Kadriu: A ka ndonjë shenjë?

Abdullah Zeneli: Ka shumë shenja, ka shumë shenja, absolutisht. Ka pasë miniera të shumta, ka pasë...Zona e thellë e Llapit atje në grykë është e jashtëzakonshme, ka lokalitete që quhet Pallatë,

është fshati Pollatë për shembull, ajo është ndërtuar sipas gjuhësisë me pallate ka qenë. Ka qenë miniera e arit dhe argjendit, mendohet që një qytet i ashtuquajtur Kosova ka qenë në grykën ku buron Llapi për shembull dhe unë me ato legjenda, me ato rrëfime jom rritë qoftë te familja ime domethanë nga ana e babit por edhe te dajët kur shkojshim në Llapashticë, Llapashticë e epërme. Ato rrëfimet me katallajtë që quheshin diva, me këta gjigantët e me këto, ne na dukeshin sikur rrëfime por po i analizove, po hyre në letërsi, po hyre në mitologji janë gjëra që i njeh shkenca domethanë shkenca i njeh qytetërimi, i njeh mitologjia, të gjithë me këtë botë jemi rritë dhe kjo e ka formuar domethënë atë vizionin, atë si të them zgjerimin e horizontit për ta parë botën pak më ndryshe dhe për ta zhvilluar qoftë profesionin apo edhe kënaqësinë e leximit, bie fjala.

Aurela Kadriu: Universitetin a e keni përfunduar...A keni qenë në Prishtinë apo?

Abdullah Zeneli: Unë kam pasë fatin që të punoj me librin edhe Matematika me korrespondencë ishte e pamundur të vazhdohet edhe kam kaluar në Letërsi. Në Letërsi s'e kam pasë asnjë problem, natyrisht ngadalë-ngadalë kom diplomuar, diku notën mesatare tek 8,5-9 e kam pasë, po letërsinë ndoshta është mungesë modestie ta them, por është diçka e jashtëzakonshme. Unë kur kam shkuar në provime s'e kam konsideruar veten student, e kam konsideruar veten barabartë me arsimtarët. Përballesh me arsimtarët, isha shumë refuzues në disa pikëpamje ose disa qasje. Kam qenë shumë kritik ndaj realizmit socialist, ndaj asaj letërsie tepër domethanë të njëanshme, kom pasë fatin që të lexoj libra edhe në gjuhë tjetër, sidomos në kroatisht e në serbo-kroatisht s'kishte libër që s'përkthehej derisa i frekuentoja panairët. Natyrisht ma vonë edhe panairët ndërkombëtare ku nëpërmes frangjishtes kam arritë që...

Aurela Kadriu: Në cilin vit fillut me studiu letërsinë?

Abdullah Zeneli: Letërsinë menihere mas shërbimit ushtarak, në 1976.

Aurela Kadriu: Ku keni qenë në shërbim ushtarak?

Abdullah Zeneli: Në Leskovc. Katërmëdhjetë muaj kam qenë në Leskovc.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë?

Abdullah Zeneli: Pooo...Si ushtar. Fati që s'më ka zanë '81-shi se do të ktheheshim në arkivole, siç ndodhi. Kam qenë shumë luftëtar, luftëtar i çashtjes, i detyroja ta shikoj atë pak televizion në shqip që ka qenë, që të mos më privohej e drejta që o' dhanë në atë kohë, të mos merrem me ushtrime të ndryshme ushtarake po ta shoh një emision që ishte në gjuhën shqipe, kam qenë luftëtar shumë i madh i të drejtës në atë kohë në Leskovc, unë habitem, po të më zinte '81-ta, fati im do të ishte krejt ndryshe.

Aurela Kadriu: Në '73-tën thatë që e latë matematikën...

Abdullah Zeneli: Po mandej kam zënë punë në "Rilindje".

Aurela Kadriu: Si çka?

Abdullah Zeneli: Si referent i shitjes së librit domethanë kom qenë në shitjen e librit. Edhe ngadalë-ngadalë kam arritë në mesin e viteve '80, '84 të avancohem në shefin e shitjes së librit, kam njoftë shumë, shumë shitjen e kam njoftë, domethanë përhapjen e librit, gjithmonë me vizionin që një ditë do të merrem edhe me pjesën kreative të librit. Kam shkruar, kurrë s'e kam ndaluar shkrimin. Në atë kohë kam njoftë penat ma të mira dhe kam qenë me ta aty në "Rilindje", Anton Pashku, Ali Podrimja, Rifat Kukaj, Fahredin Gunga, shkrimtarët ma të mirë që ka pasë në atë kohë, njohje që në vitin '78 e tutje kam pasë miqësi të madhe me Ibrahim Rugovën bie fjala, me Rexhep Qosjen, me të gjithë njerëzit e letërsisë edhe jom brenda saj, jom brenda saj, pavarësisht që kurrë s'më është shqitur dëshira për matematikën dhe shkencat e tjera sepse këto e plotësojnë njëra-tjetrën, e krijojnë harmoninë e përgjithshme.

Aurela Kadriu: Qysh është reflektu gjendja politike në "Rilindje"?

Abdullah Zeneli: Shumë, shumë vështirë, shumë randë, shumë randë edhe fundi i fundit ai pushtet për ta shkatërruar atë zhvillim që ishte...Se gjithë ajo që ndodhë '81 e tutje ka qenë ndalimi i zhvillimit të qenies shqiptare në ish-Jugosllavi. E tmerrshme ka qenë. Po që krijuar baza edhe jemi popull që mbijetojmë katrahurat, i mbijetojmë tragjeditë.

Aurela Kadriu: Tregomë pak ma detajisht qysh e përjetojshit...

Abdullah Zeneli: Shumë, shumë e randë ishte sepse u larguam nga lokalet e "Rilindjes". Ne redaksia e botimeve ka qenë në katin e nantë, na largun nga kati i nantë.

Aurela Kadriu: Në cilin vit?

Abdullah Zeneli: '92, 1992, ajo ka fillu në '90, filloi...

Aurela Kadriu: Në '81-tën...

Abdullah Zeneli: Në të '81-tën ndërprerja me Shqipërinë ishte e tmerrshme, domethanë me Shqipërinë u ndërpre...

Aurela Kadriu: Deri në atë kohë ju shkëmbejshit me Shqipërinë?

Abdullah Zeneli: Po shkëmbejshim botime, libra, merrnim nga Shqipëria çdo muaj me maune libra, shpërndanim edhe libra sidomos të letërsisë së përkthyer por edhe të letërsisë origjinale, romane të ndryshme, vepra të ndryshme, po përkthimet letrare ishin të jashtëzakonshme.

Aurela Kadriu: Pse ndodhi, qysh u reflektu qajo shkëputja me Shqipërinë mandej...

Abdullah Zeneli: Po ajo gjoja u marrë si pretekst ngjarjet që ndodhën i kualifikuan se ato nuk filluan, fillimisht ishin protesta të studentëve për kushtet e vështira e për këto, mirëpo ajo ishte paramendim i pushtetit që ta shndërronte ndryshe këtë domethanë që gjoja ishin kundërrevolucionarë për

përmbysjen e rendit kushtetues edhe filluen edhe burgosjet e filluen ndalesat, filloi domethanë faktikisht u vu trari i bashkëpunimit me Shqipërinë edhe faktikisht ajo ishte një sinjal i qartë që do të pengohej zhvillimi i shqiptarëve në ish-Jugosllavi se filloi një shpërthim i madh. Ju e dini Akademia e Shkencave, Kosova në 1974-tën u avancua, ishte pothuajse republikë, ju pengonte, filloi zhvillimi i madh, zhvillohej edhe në aspektin e fabrikave, industrisë e të gjitha, kishin detyrim të gjitha republikat prej Sllovenisë e deri te Maqedonia kishin detyrim që të investonin në Kosovë. Filloi Kosova ta merrte veten pak a shumë, natyrisht shumë ngadalë në krahasim më trendin që është dashtë të ecë përpara, po megjithatë kishte një trend ecjeje edhe ajo nuk shihej me sy të mirë edhe u morr si pretekst '81-ta dhe fillun probleme shumë të mëdha, nja dy-tri vjet kanë qenë shumë të randa, dy-tri vite, mandej ngadalë-ngadalë, ngadalë-ngadalë morrëm frymë disi, edhe fillun protestat, ju e dini me '87, '88, qoftë të minatorëve, qoftë kur fillun ndryshimet edhe asaj pak autonomie që kishte, edhe ajo të na merrej, atëherë natyrisht ishte një popull s'mund ta toleronte këtë, edhe eskaloj në ato që ndodhën.

Qe parapa një diçka e tmerrshme për shqiptarët e Kosovës por ishin në atë kohë zhvillimet ose fryma e organizimit shoqëror që nuk e desh luftën në atë fillim, edhe është diçka shumë e mirë dhe pastaj u zhvendos në Bosnjë dhe Kroaci ajo që qe parapa të ndodhte në Kosovë sipas asaj çfarë flitej, se nuk kam qenë pjesë e si të them, asaj nomenklature, mirëpo ajo që është menduar që të bëhet ajo ployë në Kosovë, u zhvendos në Kroaci edhe në Bosnjë. Pastaj, natyrisht ngadalë-ngadalë ishte koha që duhej edhe me armë që të realizohej ajo..

Aurela Kadriu: A na tregon kur ju largun prej punës, prej “Rilindjes”, kur u mbyll “Rilindja”.

Abdullah Zeneli: “Rilindja” faktikisht proceset fillun me '90-tën, domethanë edhe çdo vit vinte vështirë e ma vështirë, në '92 e në '93 fillun na largun edhe prej lokaleve ose duhej të paguanim qira, ose...domethanë ishte e tmerrshme ajo.

Aurela Kadriu: Qysh funksionu mandej, a vazhdu?

Abdullah Zeneli: Po mandej dolëm sikur shkollat që u bonë bodrumet-shkolla, universitetet, edhe ne fillum të organizohem jashta objektit të “Rilindjes” edhe mbijetum. Natyrisht në atë kohë unë kam përdorë edhe strategjinë e shtëpisë botuese “Buzuku”, që e regjistrova, në momentin kur mbyllej “Rilindja” unë e regjistrova në 1990 shtëpinë botuese, edhe nuk e kam regjistruar në Prishtinë se nuk ma regjistronin në Prishtinë, duhej lokali, duhej kishin do rregulla tepër strikte për t'regjistruar ni biznes, duhej edhe të deponoje n'bankë mjete, jo sikur sot që pa asnjë çindarkë ti mundesh ta bësh një ndërmarrje. Për fat të mirë kishte njerëz shumë të mirë, kam shkuar n'Gjakovë, në Gjykatën Ekonomike në Gjakovë, e kam regjistruar n'Gjakovë, edhe m'shërbente kjo selia n'Gjakovë me Prishtinën edhe humbja do me thanë, i humbja fijet e, e do me thanë pushtetit që të ma ndalonte punën, duhej, edhe në këtë punë duhej shkathësi, ja kam dalë do me thanë që të, të... nuk ishte kumeditë ndonjë mori të madhe trimëria sa ishte dituria do me thanë vizioni për të ditur që të...

Aurela Kadriu: Pastaj a ka vazhdu “Rilindja” me të njejtin emër?

Abdullah Zeneli: “Rilindja” ka vazhduar deri pas luftes, do me thanë është rruajt emri, është rruajt personeli është rruajt e gjitha. Mas ’99 me ardhjen do me thanë edhe largimin e forcave serbe filloi një ndryshim krejt tjetër.

Aurela Kadriu: A keni qenë edhe te Bujku?

Abdullah Zeneli: E “Bujku”, domethanë “Bujku” e përdori ndalesen si gazetë e “Rilindjes” s’përditshme u shndërru në “Bujku” po pastaj mas luftës filloi të dalë “Rilindja” si “Rilindje” mirëpo filloi..

Aurela Kadriu: A ishit ju njerëzit e njejtë?

Abdullah Zeneli: Ne, te fusha e librit po, te fusha e librit po, mirëpo ishte një ndryshim krejt tjetër, ndoshta faktori njeri ka ndikuar që ato apetitet, orekset e disa njerezve për të ardhur te pushteti për të ardhur te ato, krijoi do probleme tjera. Nuk kam pasë kohë ma t’merrem me kto gjana sepse nuk janë sjellë mirë, une e di çfarë kam kontribuar që t’ruhet ajo pasuri e librit ajo, ai emër i mirë i “Rilindjes” t’ruhet edhe deri ‘99 erdhi liria, ata e vazhduen nuk e deshen ndihmen time, atëherë n’rregull.

Aurela Kadriu: Çka ndodhi në atë moment?

Abdullah Zeneli: E vazhduan, e vazhduan por nuk shkoi shumë larg edhe u mbyll dhe edhe pse ka qenë n’kuadër të Ministrisë së Kulturës që u formua në 2002 e tutje, ka qenë gjashtë, të ardhura personale, rroga, paguante ministria veprimtarinë botuese ua ndaloi, në atë gjashtë nuk kam qenë unë po të isha unë nuk do ta lejoja, sepse do të përdorja t’gjithë mekanizmat deri në Kombet e Bashkuara po ata që mbetën nuk arritën të gjinden si duhet, atëherë unë vazhdova me punën time. Kam arritur të krijoj traditën e Panairit t’Librit kah ‘99-ta, kam arritur që t’i ndihmoj botuesit e Shqipërisë që s’ka qenë askund, do me thanë në periudhën ‘95, ‘97, ‘98 . Panairi i parë që është bërë në Tiranë ‘98 është meritë e iniciativave nga Kosova që janë marrë, janë dokumentet origjinale që kemi nenshkuar në Frankfurt, kem bo shumë punë rreth homogjenizimit, rreth lidhjeve të mira edhe sot është ndër veprimtaritë më të mira libri, libri është shndërruar në industri sot, natyrisht ka konkurrencë edhe ku ka konkurrencë unë e shoh pozitive se konkurrenca sjell edhe cilësinë, sjell cilësinë, sjell edhe fiton lexuesi tek e fundit.

Aurela Kadriu: Ku keni qenë në kohën e luftës?

Abdullah Zeneli: Si refugjat në Korçë, njëqind ditë.

Aurela Kadriu: N’Korçë?

Abdullah Zeneli: N’Korçë, po se një javë Bllacë nuk dinim kur erdhi urdhri që t’zbrasej kampi, na ngarkun napër autobuse nuk dinim ku po shkojmë.

Aurela Kadriu: Kur keni shku në Bllacë?

Abdullah Zeneli: Në Bllacë dikun me 30-31 mars, në këtë periudhë...

Aurela Kadriu: Domethanë, n'cilin vit?

Abdullah Zeneli: N'99-tën de, menjëherë mas 24-shit, bombardimet në mramje katër-pesë ditë qëndrum në Prishtinë erdhën pastaj forcat policore na hodhën jashtë edhe ai marshi, nga..

Aurela Kadriu: Pas bombardimeve keni shku a?

Abdullah Zeneli: Pas bombardimeve, katër-pesë ditë pas bombardimeve, unë nuk largohesha sikur t'mos ishin forcat, një javë ishte në Bllacë dhe e tmerrshme ajo periudha e Bllacës. N'Korçë, po n'Korçë kam pasë fatin e mirë që menihere libri më shpëtoi edhe në Korçë, lexoja nga dyqind faqe n'ditë ai m'shpëtoi nga, nga sepse ne i lamë të gjitha nuk e dinim çfarë do të ndodhte, i lamë t'gjitha çfarë kishim bërë për gjithë jetën i lamë, mbetën edhe nuk dinim çfarë do të ndodhë a do të kalleshin, s'e di.

Aurela Kadriu: Ikët prej shpive?

Abdullah Zeneli: Po, po ishim, domethanë erdhën në t'gjitha lagjet policia me ato ushtarak me t'gjitha ato edhe..

Aurela Kadriu: A ka vazhdojke kjo kolona?

Abdullah Zeneli: Kolona drejt te stacioni hekurudhor, aty grumbullimin na ngarkun t'nesrit në mëngjes nepër trena, nuk dinimin ku po shkonim.

Aurela Kadriu: N'cilat rrugë shkojshi?

Abdullah Zeneli: Do me thanë, rrugës zbritem nga kisha sot është serbe lart atje, rrugës kryesore nga përmendorja, te qafa rruga drejt...

Aurela Kadriu: Përmendorja?

Abdullah Zeneli: Përmendorja, trekandshi që është ajo aty edhe drejt, e kam pa një skenë shumë t'çuditshme te kjo ura rreth rrotullimi që shkon nalt te Komuna e Re n'Dragodan, n'Arbëri si thuhet edhe e kam pa një skenë makabre që kurrë nuk më hiçet nga mendja. Ni polic, ni ushtarak serb kishte, kishin hedhur flamurin e Shteteve t'Bashkuara të Amerikës në tokë edhe ai ishte në mes të flamurit me atë armatim të tij deri në dhëmbë kur e kam pa atë skenë kam pasë një optimizëm që kta janë t'çmendur edhe liria do të vijë një ditë, se t'i bëhej flamurit amerikan ni, ni përdhosje e tillë është e pa tolerueshme, ajo skenë nuk më hiçet nga mendja domethanë, se ju e dini, ambasada, përfaqësia s'ka qenë larg e Amerikanëve e kanë marr flamurin si dukej nga përfaqësia amerikane, edhe kishin hedh një flamur shumë i madh, shumë i madh, në mesin e flamurit ishte ai i armatosur, ai ushtaraku, a polic, a diçka si paramilitar, a çfarë mund t'ketë qenë, bile bile edhe nuk guxonim as shumë ta shikonim se mund të largonte nga kolona edhe t'pushkatonte n'ven, e tmerrshme çfarë përjetimi ka qenë ajo.

Aurela Kadriu: A shkut knej ka qafa?

Abdullah Zeneli: Po ka qafa edhe në stacion të trenit ajo natë...

Aurela Kadriu: Ka është “Xhevdet Doda” tash apo drejt?

Abdullah Zeneli: Jo drejt, domethanë, stacioni hekurudhor ku është edhe sot aty edhe...

Aurela Kadriu: A qëndrut ni natë?

Abdullah Zeneli: Ni natë, deri në mëngjes as gjumë s’kem bo se nuk e dinim çfarë po ndodhë, ndëgjoheshin lart te pjesa e Arbërisë, Dragodanit, dëgjoheshin do rafale me të thanë të drejtën i kam thanë edhe grus kujdes po ju hedhimi fmisë se tash vijnë edhe na pushkatojnë, kam llogaritë që edhe na pushkatojnë, domethanë asi gjendje psiqike ka qenë që kam qenë thjesht i përgaditur se do të vijnë t’na masakrojnë sepse ishim në qiell të hapur edhe ishin në t’gjitha antë krisma automatikësh, rafaresh ishim në mëshirë të, të, të si thuhet, të zotit. Të nesërmen erdhën trenat, si kafshë na ngarkunë, 24 vetë i kam numru kanë qenë me një kupe 24, edhe nuk e di a do t’na çojnë nga lart për Serbi, a do t’na çojnë për Nishë, për Kralevē. Në Fushë Kosovë mori drejtim nga Shkupi, ishte një optimizëm domethanë pra aty ishim me fat, ni tren para nesh kishte pasë shumë tortura, fati, treni ynë nuk pati edhe pse përjetova një ndamje të familjes, gjysma e familjes në një vagon tjetër se ishte e pamundun në atë zëri njerëzish edhe derisa deri na zbritën në Han të Elezit nuk e dija se çfarë ka ndodhë as me familjen, çfarë ka ndodhë me pjesën tjetër.

Aurela Kadriu: Kufinin e keni kalu në kamë?

Abdullah Zeneli: Në kamë pastaj nëpërmjes binarëve të hekurudhës kalum në pjesën e Bllacës, ajo pjesa fushore që ka qenë, domethanë si ta them, toka e askujt që thuhet në mes dy kufijëve edhe një javë ditë unë kam pa skena, kanë qenë edhe dy-tre qind mijë njerëz.

Aurela Kadriu: Qysh u bashkut me familjen mandej?

Abdullah Zeneli: Po në atë zbritjen që, që na zbriten nga treni pastaj u gjetëm kishin qenë me ni vagon tjetër edhe kur zbritën pastaj kur erdhën në atë hapësirë natyrisht kaluam naten e parë nuk e dinim çfarë do të ndodh, një natë, e një natë binte shi, bënte një ftohtë, një dimër, tmerrshem, dimër s’ka qenë se pranvera veç kish ardhë ishte 29, 30 me 1 prill mandej kaloj do me thanë, dikun me 6 prill kem shku në Korçë po filloi të nxehet koha, të mos vinte urdhëri të mos lshohej Bllaca aty plaste kolera, smundjet e randa, sepse filloj të nxehet koha mbeturina njerëzit kishin si ajo mizori e njerëzve, dy qind mijë njerëz tash paramendoje çfarë mbeturina e çfarë ndodhën në atë kamp, i kam përshkruar kto e kam librin “Toka Shqiptare” që kam shkruar sa kam qenë në Korçë është botuar në vazhdime nuk e kam ditë që do të bëhet libër. Çdo javë përshtypjet e mija qoftë të Bllacës, qoftë të jetës në Korçë, qoftë të riminishenca të jetës së përparshme i shkruaja dhe botoheshin në një gazetë lokale në Siti n’Pogradec, edhe qëndruam 100 ditë, ajo botuesja Afroviti Kusho më kërkoi edhe disa vazhdime t’i leja se pastaj ndodhi fati që hynë Forcat e NATO-s në Kosovë edhe u kthyen të gjithë me aeroplan, me helikopter të Natos nga Korça në Kukës na kanë sjell..

Aurela Kadriu: Pse?

Abdullah Zeneli: Po ishin Forcat e NATO-s me helikopter, ata me helikopter na kanë sjell, ata helikopterët e mdhoj 26 vetë i kam numëruar kem qenë në bord të helikopterit do me thanë mbetëm, ne, dy familjet e fundit edhe prej Korçës bile është ajo pjesa e Drenovës ku ka origjininën, vendlindjen Aleksandër Stavre Drenova që është shkruesi i Himnit Kombëtar Shqiptar mandej është Boboshtica ishte afër Korça, unë, në një far mënyre është djepi i kulturës shqiptare n’Korçë edhe unë jam inkuadruar shumë në rrjedhat e kulturës së Korçës menjëherë do me thanë edhe pjesën e shkrimtarëve të teatrit, muzikës t’gjitha edhe habiteshin se si ne e njihnim atë mentalitet, atë filozofi, atë zhvillim. Korça është ndër qytetet që ka traditë mllagë kulturore. Shkova e vizitova shkollën e parë t’vashave, shkollën e parë që u hap abc-ja ajo muzeu, shkolla e parë e Pandeli Sotirit që u hap pastaj s’kishte vend që s’kishte monument Korça edhe n’atë tragjedi n’atë vështirësi që kishim si refugjat kishte diçka pozitive do me thanë me e plotësu jetën në ato rrethana edhe doli libri “Toka Shqiptare” është shkruar dhe është botuar në vazhdimë pastaj botuesja i mbledhi ato të gjitha edhe u bo libër, një libri që lidhen faktikisht janë përjetimet e mia, qoftë në Korçë, qoftë sareminishenca, të jetës së mahershme të, të përfshira në atë libër, e kshtu.

Aurela Kadriu: Ku keni qëndru në Korçë, a keni qëndru te naj familje?

Abdullah Zeneli: U tregu ni familje vullnetare, na e dha hapësirën kishte qenë një banesë bosh sepse pronari i saj jetonte në Greqi, punonte, dhe banesa ka qenë një dhomëshe dhe kuzhinë, një dhomë dhe kuzhinë dhe e gjithë familja, kisha edhe nanën atëherë gjallë, edhe kem jetu aty domethanë njëqind ditë, pastaj kur hyn forcat nana me motrën edhe me djalë timin erdhën menjëherë ndërsa unë kisha një angazhim se përpiqesha të realizoja dramën për Nanën Terezë se ishte program, nuk pata fat atëherë u kthym ishte urdhër që të ktheheshim edhe ndodhi kjo e helikopterve.

Aurela Kadriu: Kur u kthyt?

Abdullah Zeneli: Diku te pesë-gjashtëmbëdhjetë korriku.

Aurela Kadriu: E qysh e gjetët...

Abdullah Zeneli: Për fat, kishte pasë disa damtime por jo në masën që kam pasë frikë, dëmtime vjedhje të kompjuterëve, ndonjë printer ose ndonjë diçka po për fat substanca e librit, pasuria ime ma e madhe, biblioteka ishte ruajt. Unë kam përdor pak një mjeshtri, kam hedh librat në tokë nga vitrinat që t’krijohet përshtypja nëse vjen naj kontrollë t’krijohet përshtypja që paska qenë dikush para nesh dhe qenkan libra t’parëndësishem, domethanë i kam hedhë në tokë, t’gjithë librat, dikund mbi 10 mijë tituj kanë qenë të, të bibliotekës personale po flas jo botimeve që kam pasë diku tjetër. Ka qenë një lloj si garazhë, si, s’lente përshtypje që ka libra aty që të mos krijohet diçka do me thanë meniherë dhe ka kalu aty si pavrejtshëm, mjeshtria është t’i kamuflosh gjërat. Ju e dini edhe tanksat kamuflohen me do gjethe me do degza që t’mos shihet që është tanks do me thanë ka edhe çdo duhet ta fusësh edhe artin se arti luftarak është shumë interesant është art në veti, filozofi në veti edhe njeriu duke lexuar mson.

Aurela Kadriu: Qysh ka vazhdu jeta e ju juj mbas luftës?

Abdullah Zeneli: Po mas ishte në fakt, ishte shumë e vështirë, duhej kredi, erdhën bankat e para m'kujtohet kredia e parë e pata marr pas një periudhe shumë t'shkurtë e organizum panairin e parë erdhën librat nga Shqipëria u hap tregu u krijun mundësitë. Qëllimi ka qenë të ndihmohen botuesit pavarësisht që zhvillimi ka edhe disa probleme, ka edhe konkurrencën dikush ecë ma shpejt përdor, përdor brrylet, i përdor disa mundësi tjera dhe unë s'kam pasë ambicie kshtu si thuhet t'ja za dikujt diellin, kam punu ngadalë-ngadalë me kredi, ambiciet e mia kanë qenë të ruaj substancën, të eci, një zhvillim i ngadalshëm por i mirë edhe ja kam dalë.

Aurela Kadriu: Çfarë libra keni botu deri tash? Që jeni autor vet.

Abdullah Zeneli: Po kam dikun rreth 6 libra të botuar, i kam nja 7-8 dorë shkrime qoftë tregime, romane, drama që presin ditën e botimit, për poezi kam me siguri tre-katër libra, jam shumë aktiv edhe në *Facebook* lëshoj shpesh poezi kështu e kam. Poezia është një shprehje, një lirim, një shfryrje e emocioneve, shfryrje e ngarkesave që ka njeriu në jetën e përditshme dhe është kënaqësi, arti është diçka, arti ta plotëson jetën dhe unë jam plot tash sidomos tash që kam dal edhe në pension jetoj me krijimtarinë, jetoj me letërsinë, jetoj me librin kulturën zhvillimet, n'fushën e artit ka ecë shumë përpara sidomos në fushën e librit bota shqiptare. Po si shtëpi botuese kam arritur të botoj deri tash njo 700 tituj që është shumë e rëndësishme natyrisht, pothuajse është financimi personal edhe përpiqem të ndihmoj shumë të rinjtë. Tendenca ose qëllimi im është të ndihmoj të rinjtë, duke e ditë çfarë kam përjetuar dhe duke mos pasur ndonjëherë as, as idenë për rrugëdalje se ndonjëherë të ngushtohet hapësira e veprimit. Kam dëshirë shumë që të rinjtë t'i mbështes edhe besoj që ja kam dalë është, e din ata që i kam mbështetë. Autorëve nuk ju marr para kurrë për botim, përpiqem që me atë dijen time ta përkryej çdo botim që dal po kujtoj që ja kam dalë edhe në fushën e përkthimeve sepse unë botoj librat ma t'mirë që janë trend i botës i botoj shumë shpejt, i botoj shqip.

Aurela Kadriu: A i perktheni vet?

Abdullah Zeneli: Jo, kam perkthyes, nuk kam kohë. Nga frangjishtja do të mund të perktheja po nuk, domethanë, ma merr kohën, unë duhet të merrem me vizionin, me planin, me organizimin edhe tash llogarite bie fjala katër vitet e fundit romanet më të mira të letërsisë franceze që janë vlerësuar me çmimin *Goncourt* që është nobeli i Francës e kam marr të drejtën e botimit dhe i kam botuar unë si shtëpi botuese ose nobelet e fundit kto katër-pesë vitet e fundit me Padje Podjamo me Svetlana Aleksieviq edhe shumë të tjerë. Do me thanë i kapi trendet edhe romanet e tjera që janë shumë trend në botë po them në fushën e letërsisë sepse jetoj me artritjet e letërsisë, për mu është një disfaksion shumë i madh që kam respektin shumë t'madh nga shtëpitë botuese me renome t'botës sidomos me t'Francës dhe Parisit me *Gallimardi...La Marjon* botues tjerë do me thanë Akcyd, me Akcyd kam një raport shumë të mirë kam botuar dy autorë ma t'njohur që janë sot për sot në Francë, është Matjas Enar edhe fituesi i *Goncourt* të vjetëm Metrik Vujar që kam raporte shumë të mira por që është interesant momenti kur vitin e kalun fitoi në zgjedhje Emanuel Makron e bani minister të kulturës e emërtoi botuesin e Akcyd edhe do me thanë ishte vizioni i tij. Unë pata rastin ta kem shok nga afër në ceremoninë e hapjes të panairit të Frankfurtit ku ishte mysafire e panairit, Franca, edhe në ceremoninë e hapjes ishte Emanuel Makron dhe Angela Merkel ishte një kënaqësi e madhe që kishe

ftesën nga organizatori që t'jesh pjesë e atij evenementi, e atij aktiviteti është kënaqësi për vetën se kam kontribuar diçka në fushën e librit që organizatori të fton të jesh pjesë e atij aktiviteti ose bie fjala Salon De Livre që u mbajt para një muaji në Paris takova se kisha larg as presidentin Makron por në një nga ditët shfrytëzova rastin që të nënshkruante librin Kryeministri i Frances Eduard Filip. Mora të drejtën e botimit, libri është i gatshëm për panairin e ardhshëm t'Prishtinës pas nja dy javë ditësh t'jetë i gatshëm libri, kta e ka lexuesi ynë dhe është titull shumë interesant, njerëzit që e lexojnë do me thanë kapen me fenomene e lexueshmerisë që neve kemi nevojë shumë që ta afirmojnë edhe ta ndikojnë në shprehinë e leximit sepse arsimit ynë, familja jonë, mjedisi ynë, shoqëria jonë duhet të bëjë të pamundur që t'krijoj, t'kultivoj shprehinë e leximit, në qoftëse kem arrit sepse t'gjitha ato që kam arrit unë vet ai fëmija i fshatit që ka ardhë 4 vjeç në Prishtinë, kam arrit diçka, nëse kam arritur duke iu falenderu leximit.

Aurela Kadriu: Nëse nuk keni asgjë me shtu z.Zeneli, faleminderit shumë për intervistën.

Abdullah Zeneli: Faleminderit prej jush ishte një kënaqësi u mundova ta shpalos ashtu në vija të trasha ashtu siç thuhet një jetë me librin dhe do të isha falenderues nëse kam arrit të them diçka. Faleminderit shumë.